



**BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 15 Datë 06.03.2015

**“PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK
TË TIRANËS NR.28, DATË 23.12.2014, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM 2015-2017 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË
SË TIRANËS PËR VITIN 2015”**

Në mbështetje të nenit 19, pika 9 dhe nenit 32, gërma “dh” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 39 dhe nenit 44 paragrafi i dytë shkronja “a” të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2, datë 06.02.2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.28, datë 23.12.2014, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015”; njoftimit në formë elektronike të shkresës me nr.prot 18081/1 datë 22.12.2014 të Ministrisë së Financave për transfertën e pakushtëzuar të vitit 2015, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë një shtesë në pikën 1.1 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.28, datë 23.12.2014, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015”, në shumën totale **230,623,849 lekë të përbërë nga:**
 - a-fondi i mbartur nga viti 2014**, sipas akt-rakordimeve me Degën e Thesarit të Tiranës në shumën 99,385,245 lekë,
 - b- shtesa në transfertën e pakushtëzuar të vitit 2015** në shumën 131,238,604 lekë

Këto fonde janë të detajuara sipas pasqyrës nr.1, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Në zbatim të pikës 1 a-b, të miratojë ndarjen në 1-mujorë të fondeve, sipas aneksit nr.1 pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Të miratojë një shtesë në pikën 1.1 të vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.28, datë 23.12.2014, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015”, të fondit të mbartur nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve në shumën 117,880,443 lekë, detajuar sipas tabelës nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Të miratojë rishpërndarjen e fondeve ndërmjet programeve të Shërbimeve Publike, Menaxhimit të Rrugëve dhe Transportit Publik, Programit të Arsimit dhe Programit të Kujdesit Social sipas pasqyrës nr.3, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
5. Të miratojë detajimin e fondit brenda Programit të Kulturës tek zëri Projekte Kulturore sipas pasqyrës nr.4, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, të kryejë sistemimet në buxhetin e vitit 2015 në të ardhurat dhe shpenzimet sipas pikave 1, 2, 3,4,5 të këtij vendimi.
7. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Prokurimeve, Drejtoria e Financës, Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Drejtoria Nr.3 e Punëtorëve të Qytetit, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Njësia e Menaxhimit të Projekteve për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

